

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI**

**SHOQËRIA "VIAR-CONSULTING" SHPK**

**TIRANË, SHQIPËRI**

AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
i  
Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

Shoqëria "VIAR- CONSULTING" Sh.p.k

KAPITULLI I  
Data e Themelimit, Emri, Forma, Selia, Kohezgjatja

**Neni 1. Data e themelimit dhe Emërtimi**

1. Sot, më datën 13/07/2022 kam themeluar shoqërinë "**VIAR-CONSULTING**" sh.p. k (në vijim "Shoqëria"), e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi "Shpk", cili përfaqëson formën ligjore të saj, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
2. Themeluese e shoqërisë, Znj. Fatime Alliu, e bija e Qemalit, lindur më 10.02.1962, në Librazhd, dhe banuese në Tiranë, adresë: BLV. Bajram Curri; nd. 238; h. 2; ap. 13; njësia administrative nr. 1; 1004; Tirana, Shqipëri, identifikuar me kartë kombëtare identiteti G25210338Q, madhore me zotësi të plota juridike për të vepruar.
3. Emri i shoqërisë është "**VIAR-CONSULTING**" sh.p.k. (në vijim "Shoqëria"), e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi "Shpk", cili përfaqëson formën ligjore të saj, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
4. Ortaku i vetëm i Shoqërisë ("Ortaku i vetëm"<sup>1</sup>) gëzon përgjegjesi të kufizuar deri ne limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqerisë te perfaqesuar ne kuota.
5. Në të gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet të leshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyra e dërgimit, emri i saj do të ndiqet ose do të shoqërohet nga:
  - fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "shpk".
  - numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) të saj.
  - adresa e regjistruar: Njësia Bashkiake Nr.2; Rruga "Luigj Gurakuqi"; P.18; H.4; K.6: Ap.21; Tirana, Shqipëri.
  - dhe pasqyrimin e faktit që shoqëria është në procedura likuidimi, në qoftese ky rast paraqitet
  - Emri tregtar: Studio "VIAR-CONSULTING" sh.p.k.
  - Adresa zyrtare e email-it të shoqërisë është: [info@viar.al](mailto:info@viar.al)

**Neni 2. Forma Ligjore**

1. Shoqëria është një entitet ligjor shqiptar, dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjesi të kufizuar ("shoqëri me përgjegjësi të kufizuar"), në pajtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqërите Tregtare" ("Ligi i shoqërive").

**Neni 3. Selia**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njësia Bashkiake Nr.2; Rruga "Luigj Gurakuqi"; P.18; H.4; K.6: Ap.21; Tirana, Shqipëri. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në

*Allinf*

<sup>1</sup> Ortatët /ortakëve =>Ortaku i vetëm

një adresë dhe/ose në një qytet tjeter të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 4. Kohëzgjatja**

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është për një periudhë të pacaktuar.

**KAPITULLI II**  
**Objekti**

**Neni 5. Objekti i Shoqërisë**

1. Objekt i aktivitetit të shoqërisë është:

*Auditues Ligjore (Ekspert Kontabël i Autorizuar):*

*Kryerja e angazhimeve që përbajne misione të kontrollit ligjor të llogarive, misione të auditimeve kontraktuale, shërbime të tjera të sigurisë dhe shërbime të lidhura sipas përcaktimeve të bëra për to nga Federata Ndërkombetare e Kontabilisteve, kur ato janë në pajtim me natyrën e profesionit dhe me kërkesat e legjislacionit në fuqi, të cilat kërkohen nga entitetet ndryshme publike dhe private. Konsulencë ekonomike, financiare dhe fiskale për shoqëritë tregtare, personat fizike, individe dhe organizata të tjera, të njoitura nga legjislacioni fiskal, ligji "Për Tregtaret dhe shoqëritë Tregtare" dhe Kodi Civil; Shërbime Kontabiliteti dhe të lidhura; Shërbime ristrukturimi dhe operacione të vecanta të shoqerive tregtare, lidhur me ndarjen, bashkimin, perthithjen, zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit dhe likuidimin; Sherbime ligjore ne fushen tregtare, fiskale dhe kontabile, ekspertize kontabile, analiza financiare dhe fiskale per llogari te institucioneve publike dhe private, sipas kerkeses. Sherbime si perfaqesues tatimor dhe perfaqesim te paleve te treta, sipas percaktimeve ligjore. Vleresime te aktiviteteve tregtare, vleresime te pasurive te luajtshme, te paluajtshme, aktive te tjera materiale dhe jomateriale; Pergatitje plan biznesi, buxhetime dhe analiza financiare, studime tregu, studime fizibiliteti etj. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bëjnë pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbështet atë.*

**Neni 6. Ndryshime**

1. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarise se saj në çdo kohë siç parashikohet në këtë Statut.

**KAPITULLI III**  
**Kapitali Themeltar; Kuotat e Kapitalit Themeltar**

**Neni 7. Kapitali Themeltar**

1. Kapitali themelues i Shoqërisë është 10,000 (dhjetëmijë) Lek dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 10,000 (dhjetëmijë) Lek, të nënshkruara dhe të paguara plotësisht.

*Allin F*

**Neni 8. Ortaku i vetëm dhe Kuotat e tij**

Kapitali themeltar i shoqërisë "VIAR-CONSULTING" sh.p.k është i zotëruar 100% nga Ortaku i vetëm Znj.Fatime Alliu me adresë:Njësia Bashkiake Nr.2; Rruga."Luigj Gurakuqi"; P.18; H.4; K.6: Ap.21; Tirana, Shqipëri.

**Neni 9. Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar**

1. Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Ortakut të vetëm, në përputhje me Kapitullin IV të këtij Statuti, dhe kërkesave të detyrueshme të Ligjit të shoqërive tregtare.
2. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të kontributeve në para, me anë të kontributeve në natyrë, si dhe me përfshirjen e rezervave (nëse ka) ose fitimit apo kthimit të borxhit në kapital.
3. Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet duke emëtaruar kuota të reja apo duke rritur vlerën nominale të kuotave ekzistuese. Pjesët e reja të kapitalit themeltar do të nënshkruhen dhe vlera e tyre nominale do te paguhet plotësisht.
4. Shoqëria nuk mund te bleje asnjë kuotë të saj. Megjithatë me qëllim zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, nëpërmjet vendimit për zvogëlimin e kapitalit, Ortaku mund të autorizojnë Administratorin/Administratoret të bëjnë blerjen e kuotave përkatëse dhe me pas t'i anulojnë ato.

**Neni 10. Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve**

1. Ortaku i vetëm zoteron 100% të kuotave të Shoqërisë. Në bazë të dispozitave të Ligjit të Shoqërise të drejtat dhe detyrimet e asamblese së ortakeve në shoqërinë me një ortak, do të ushtrohen nga Ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e tij do të registrohen në regjistrin e vendimeve. Një vendim i paregjistruar në këtë regjister do të quhet i pavlefshëm.
2. Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i Kuotave, transferohen tek çdo zotëruesh i ri për këto Kuota.
3. Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nga kapitali i saj dhe Ortaku mundet vetëm të mbajnë përgjegjësi brenda limitit të vlerës së kuotave që ata zotërojnë;
4. Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe ose detyrime të tjera të Ortaku të saj.

**Neni 11. Transferimi i pjesëve të Kapitalit**

1. Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen vetëm me akt notarial.
2. Pjesët e kapitalit mund t'u transferohen edhe të treteve me vendim të ortakeve të shoqërisë.
3. Pjesët e kapitalit transferohen në rrugë trashëgimie pasi të jetë marrë Vendimi i Ortakeve vetëm lidhur me kalimin e pjesave të kapitalit tek trashëgimtarët.

*Alliu F*

**KREU IV**  
**Asambleja e Përgjithshme - Ortaku i Vetëm**

**Neni 12. Kompetencat**

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të vetëm është organi drejtues i Shoqërisë i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.
2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të vetëm duhet të vodosë:
  - a. aprovimin e strategjise se Shoqërise, planit te biznesit, planeve financiare dhe buxhetit;
  - b. aprovimin e çdo ndryshimi në vijim në planin e biznesit të Shoqërisë dhe në planet financiare;
  - c. shpërndarjen e fitimeve
  - d. pezullimin e aktivitetit të Shoqërisë dhe/ose përfundimin, shpërbërjen apo likuidimin e Shoqërisë;
  - e. ndryshimet, amendimet apo zëvendësimet në aktin e themelimit dhe statutin e Shoqërisë;
  - f. ndryshimin e formës ligjore të Shoqërisë;
  - g. prezantimin e çdo kërkese për likuidim apo falimentim;
  - h. krijimin e filialeve;
  - i. strukturën e brendshme dhe organizimin e Shoqërisë;
  - j. bashkimin me shoqëri të tjera, apo ndarjen dhe shkëputjen e Shoqërisë;
  - k. zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
  - l. çdo investim të Shoqërisë, shpenzim dhe detyrim që tejkalon kufijtë e vendosura kohë pas kohe nëpërmjet vendimeve të Ortakut;
3. Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të vetëm do të vodosë si më poshtë:
  - a. emërimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabël të autorizuar dhe likuidatoreve;
  - b. përcaktimin e shpërblimit të auditoreve dhe likuidatoreve;
  - c. mbikqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të politikave tregtare nga Administratoret e Shoqërisë, përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurise së veprimtarisë;
  - d. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurise së veprimtarisë;
  - e. përfaqësimin e Shoqërise përpara Gjykatës si dhe në çështjet gjyqësore kundër Administratoreve;
  - f. çështje të tjera të cilat do të parashikohen nga Ortaku;
  - g. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve.

**Neni 13. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetëm) mund të thirret në çdo kohë nga:
  - Administratori;
  - Ortaku i shoqërisë;
  - E të tjerë konform ligjit.

*Alin J*

**Neni 14. Mënyra e Thirrjes**

2. Asambleja e Përgjithshme, Ortaku i vetëm thirret të vendosë për çështjet e paraqitura në nenet e mësipërme.
3. Asambleja e Përgjithshme Ortaku i vetëm mblidhet në selinë e Shoqërisë, në selinë e një dege të Tiranës, Shqipëri apo në çdo qytet apo provincë të botës.
4. Vendimet e Ortakut të marra në përputhje me këtë Statut si dhe me Ligjin për Shoqëritë do të jenë të detyrueshme për Shoqërinë.
5. Administratoret duhet te mbajne procesverbalet e çdo mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortaku, në perputhje me kërkesat e nenit 90 të Ligjit të Shoqërive.

**KREU V  
Administratorët**

**Neni 15. Bordi i Administratorëve dhe kompetencat**

1. Shoqëria mund të drejtohet nga një ose disa Administratorë.
2. Administrator i Shoqërise është:
  - Znj. Fatime Qemal ALLIU, lindur më 10/02/1962 në Librazhd shtetas shqiptar dhe Numer Identifikimi: G25210338Q, banues në Tiranë, adresa: BLV. Bajram Curri; nd. 238; h. 2; ap. 13; njësia administrative nr. 1; 1004; Tiranë.
  - Z. Naim Alush ALLIU, lindur më 25/06/1960 në Librazhd shtetas shqiptar dhe Numër Identifikim: G00625270D, banues në Tiranë, adresa: BLV. Bajram Curri; nd. 238; h. 2; ap. 13; njësia administrative nr. 1; 1004; Tiranë.
3. Kohëzgjatja e funksionit të Administratorëve është për një periudhë prej 5 vjetësh, duke filluar që nga momenti kur kjo detyrë merr fuqi ligjore (dmth regjistrimi prane Qendrës Kombëtare të Biznesit), me të drejtë ripërtëritje të këtij mandati.

**Neni 16 Kompetencat dhe detyrimet**

1. Kompetencat e Administratorit në kuadër të përfaqësimit të Shoqërisë përfshijnë:
  - a. Thirrjen e Asamblese së Përgjithshme, në rastet e specifikuara në nenin 13;
  - b. Menaxhimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë nëpërmjet implementimit të politikave dhe planeve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
  - c. Përfaqësimin e Shoqërisë;
  - d. Kujdesin për mbajtjen në mënyrë të përshtatshme të dokumentave dhe librave kontabel të Shoqërisë;
  - e. Përgatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor dhe raportit të ecurisë së veprimtarise së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve që i paraqiten për miratim Asamblesë së Përgjithshme;

*Alliu F*

- f. Kryerjen e regjistrimeve dhe dërgimin e të dhënave të Shoqërisë pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit, kur është e nevojshme;
  - g. Raportimin përpara Asamblesë së Përgjithshme, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndesi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
  - h. Kryerjen e detyrave të tjera të caktuara në ligj dhe nga Ortaku.
2. Administratoret mbikqyrin dhe sigurojnë që zyrtaret, agentët, të punësuarit, auditorët dhe këshilltaret e Shoqërisë të veprojnë me kujdesin e duhur dhe të mbrojnë sa më mirë interesat e Shoqërisë. Administratorët duhet të raportojnë tek Ortaku në lidhje me personat të cilët emërohen nga Ortakët.

**KREU VI**  
**Administrimi Financiar i Shoqërisë**

**Neni 17. Eksperti Kontabël i Autorizuar**

1. Ortaku duhet të caktojnë ekspertin kontabël të autorizuar në numrin dhe kohëzgjatjen e përcaktuar nga legjislacioni shqiptar.
2. Ekspertet duhet të kryejnë funksionet audituese në përputhje me legjpcionin shqiptar.

**KREU VII**  
**Aktiviteti Shoqërisë**

**Neni 18. Viti ekonomiko-financiar**

1. Viti ekonomiko-financiar fillon në ditën e parë të muajit Janar dhe përfundon në ditën e fundit të muajit Dhjetor të secilit vit. Viti i parë financiar nis në datën e themelimit të Shoqërisë.

**Neni 19. Mbajtja e Llogarive**

1. Bilanci vjetor i Shoqërisë shqyrtohet në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve (Ortakut të vetëm) dhe i paraqitet organeve tatimore sipas ligjislacionit në fuqi të vitit pasardhës.
2. Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe në monedhen Shqiptare. Shoqeria mund të këtë edhe llogari të veçanta në valutë.

**Neni 20. Llogaritja dhe Shpërndarja e Fitimit**

1. Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në bazë të pasqyrave finanziare të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme Ortaku i vetëm.
2. Shoqeria do te krijoje fonde rezerve për realizimin e objektit të saj.
3. Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mylljes së çdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund të tërhiqen nga ortaku i shoqërisë.

**KREU VIII**  
**Ndryshimi i Formes Ligjore dhe Prishja e shoqërisë**

**Neni 21. Ndryshimi i Formes Ligjore**

1. Forma ligjore e Shoqërisë mund të ndryshoje me vendim të Asamblese së Përgjithshme sipas nenit 12 këtu dhe në përputhje me dispozitat respektive në Legjislacionin Shqiptar.
2. Shoqëria e re do të përbushë të gjitha procedurat ligjore të Biznesit në Shqipëri.

**Neni 22. Prishja e Shoqërisë**

1. Shoqeria mund te prishet ne rrethanat e meposhtme:
2. si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes për të cilin ishte themeluar;
3. me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
4. hapje e një procedure falimentimi/likuidimi;
5. me vendim gjykate;
6. për arsyen e tijerë parashikuara nga Ortaket në çdo kohë.
7. Administratori(et) registrojnë prishjen e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Në rast se prishja e Shoqërise bëhet me vendim gjykata, gjykata, në perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", ia dergon vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

**Neni 23. Dispozita mbyllëse**

1. Cdo çështje tjeter, e cila nuk është përmendorur në këtë Statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

**Neni 24 Mosmarrëveshjet**

1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqerisë dhe të tretëve, do te jenë kompetente Gjykatat e Republikës së Shqipërisë.

**Neni 25 Dispozita përfundimtare**

1. Ky Statut u redaktua në 4 ekzemplare me përbajtje dhe vlera të njejtë juridike, në gjuhen shqipe dhe u miratua në parim nen për nen nga Ortaku Themelues i shoqërisë "**VIAR-CONSULTING**" sh.p.k.
2. Ky Statut nënshkruhet nga Ortaku i vetëm në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.
3. Unë, Noteri ia lexova këtë Statut me zë të lartë palës, i cili pasi e gjeti atë në përputhje të plotë me vullnetin e tij, e nënshkruan lirisht në praninë time dhe unë Noterja, vërtetoj nënshkrimet e tij sipas ligjit.

**PËR SHOQËRINË "VIAR-CONSULTING" SHPK**

ORTAKU I VETËM

  
FATIME ALLIU